



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	25.01.2021	1	vitit god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	289/2021		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 431/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.431/2020, të datës 22.12.2020, të parashtruar nga me adresë banimi Rr. "Vëllezërit Fazliu" Nr. 230, Prishtinë, kundër përgjigjes së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të datës 20.10.2020, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës-njohje e statusit të nëpunësit civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.431/2020 të datës 22.12.2020, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

me datë 22.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nr.prot:3262/2020, e regjistruar me Nr.431, kundër përgjigjes së datës 20.10.2020 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për mosnjohje të statusit të nëpunësit civil sipas legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.12.2020 ka dërguar tek Ministria e Infrastrukturës kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3364/2020, ndërsa me datën 08.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 32/2021 se bashku më shkresat e lëndës.

Kolegji ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.431/2020, e datës 22.12.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesën e datës 30.12.2020; Përgjigjen për - MI e datës 20.10.2020; E-mailin nga

për i datës 20.10.2020; Shkresën e datës 16.10.2020; Kërkesën për Deklarimin e Statusit të Nëpunësit Publik i datës 16.10.2020; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 15.12.2016; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta te datës 15.03.2017; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 04.09.2017; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 01.03.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.09.2018; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 18.03.2019; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 30.08.2019; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 28.02.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 30.06.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2019; Vërtetim i datës 14.10.2020; Certifikatë e datës 12.10.2020; Pasqyra e Trustit prej datës 15.05.2018 deri 12.10.2020; Përgjigje në kërkesë e datës 08.01.2021; kerkesën nr.8243 te datës 16.10.2020.

Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse:*

Ankuesja në ankesën e saj të parashtruar në Këshill, pretendon se kërkesa e saj e datës 16.10.2020 drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për deklarin e statusit të nëpunësit civil, nuk është trajtuar drejtë dhe kështu ka rezultuar me gjykim të gabuar material. Me tutje deklaron se ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore, që ti njihet statusi i nëpunësit civil sipas dispozitave të nenit 8 lidhur me nenin 83 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 10/2020 për Deklarimin Statusit të Zyrtarëve Publikë, duke kërkuar nga Këshilli që ankesën ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja pa ndonjë procedurë të thjeshtësuar, ka krijuar marrëdhënie kontraktuale (si ofruet i shërbimeve) me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit (si porosites i shërbimeve), për kryerjen e shërbimeve të veçanta nga fusha e detyrave dhe përgjegjësiive si Zyrtare e Arhives, Divizioni i Teknologjisë dhe Shërbimeve Logjistike. Fillimisht, ankuesja ka lidh marrëveshje për shërbime të veçanta me datë 15.12.2016, në kohëzgjatje nga 15.12.2016 deri 15.03.2017, duke vazhduar me tej me marrëveshje tjera për shërbime të veçanta me kohëzgjatje nga 15.03.2017 deri 15.09.2017, 04.09.2017 deri 31.02.2018, 01.03.2018 deri 31.08.2018, 01.09.2018 deri 28.02.2018, 01.03.2019 deri 31.08.2019, 01.09.2019 deri 29.02.2020, 28.02.2020 deri 27.08.2020, dhe 30.06.2020 deri 29.12.2020.

Ankuesja me datë 16.10.2020, përmes shkresës me nr. Prot. 1463, i është drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, më kërkesë për deklarin të statusit të nëpunësit civil, dhe po në të njëjtën ditë i është drejtuar më kërkesë të njëjtë edhe Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës.

Me datë 20.10.2020 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes e-mailit ka njoftuar ankuesen me sqarimin se pasi që ankuesja ka punuar në Ministrinë e Infrastrukturës me marrëveshje për shërbime të veçanta, e jo me kontratë të rregullt, fakt ky që nuk i ka mundësuar që të ketë statusin e shërbyesit civil. Kundër kësaj përgjigje ankuesja ka parashtruar ankesë në KPMSHC me datë 22.12.2020.



Në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa neni 83 paragrafi 17 ka paraparë se: *Ndaj vendimit për deklarimin/rregullimin e statusit të punësimit mund të paraqitet ankesë, në pajtim me ligjin, në KPMSHC.*

Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Duke u bazuar në shkresat e lëndës respektivisht në përgjigjen e datës 20.10.2020, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me kërkesën e ankueses të datës 16.10.2020, për deklarim të statusit të nëpunësit civil, Kolegji konstaton se ushtrimi i ankesës me datë 22.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pas konstatimit se ankesa ashtë e papranueshme respektivisht e parashtruar jashtë afatit ligjor, Kolegji nuk u lëshua në shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Andaj bazuar në këto rrethana, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda numër A. Nr. 431/2020

Çlirim Zeka



Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë,
- Arkivit të KPMSHC-së.

